

MARK MARKU

### ALTERPOETIKA E MARTIN CAMAJT

Për këdo që e ndjek me vëmendje jetën letrare në Shqipëri, nuk ka si të mos bjerë në sy një fakt jo i pa rëndësishëm dhe fakti është ky: edhe sot e kësaj dite në Shqipëri ka një rezistencë ndaj veprës së Martin Camajt. Kjo ndodh pavarësisht faktit se zyrtarisht arsyet e refuzimit të tij kanë rënë dhe vepra e tij qarkullon tashmë tek lexuesi i interesuar për letërsinë e veçanërisht për poezinë, pavarësisht faktit se që prej vitit 1990 vepra e tij qarkullon tashmë në Shqipëri, madje në vitin 1997 është botuar pjesa më e madhe e veprës, e tani është në proces botimi i veprës së plotë të tij, pavarësisht faktit se ai është tashmë në tekstet e shkollave dhe një referencë e rëndësishme letrare sidomos për brezin e poetëve që kanë ardhur në letërsinë shqipe pas viteve 90. Arsyet e kësaj rezistence mendoj se tashmë më tepër se politike, janë estetike, dhe rezistenca ndaj poezisë së Camajt është rezistencë ndaj poetikës së Camajt, ose më saktë ndaj alterpoetikës së tij. Sepse poezia e tillë mendoj se paraqet në kuadrin e përgjithshëm të poezisë shqipe një alterpoetikë. Një alterpoetikë, natyrisht nëse për poetikë pranojmë njërin prej tre kuptimeve të rëndësishme që na kumton ky term sipas të cilit fakti letrar është “një formë e veçantë e gjuhës dhe kuptimësimit e jo rezultat i rrethanave shoqërore, psikologjike apo politike”<sup>1</sup>.

Alterpoetika e Camajt shfaqet në letërsinë shqipe herët. Më saktë në vitin 1954 me botimin e librit të tij të dytë me poezi *Kanga e Vrrinit*, në Prishtinë në vitin 1954. Libri i tij i parë *Nji fyell ndër male* i botuar po në Prishtinë një vit më parë, mendoj se i ka shumë të pakta lidhjet me atë që unë do ta quaj këtu e më poshtë alterpoetika e Camajt. Në poezitë e botuara të këtij libri gjenden jehonat e poetikës së Mjedës apo të poetëve të tjerë katolikë të Veriut por jo një alterpoetikë. Alterpoetika e tij shfaqet siç thamë tek libri *Kanga e Vrrinit* i cili mendoj përfaqëson thelbin lëndor dhe formal të poezisë së Camajt.

Qysh me këtë libër, poezia e Camajt na shfaqet një alterpoetikë, si në raport me poezinë bashkëkohore shqiptare, ashtu edhe në raport me

---

<sup>1</sup> *Dictionnaire des littératures françaises et étrangères*, Larousse, 1992, Paris, Kapitulli Poétique.

poezinë e traditës. Nëse poezinë bashkëkohore thjesht e refuzon estetikisht, poezinë e traditës ai e shndërron rrënjësisht. Nëse në raport me poezinë bashkëkohore ai është thjesht refuzues, në raport me traditën ai është shndërrues. Ai merr nga Mjeda natyrën kontemplativo-poetizuese të cilën e shndërron në një poezi të re moderne, të çliruar nga elementet neoklasiciste si dhe nga elemente të tjerë formale.

Camaj shkon përkundër prirjeve të poezisë bashkëkohore shqiptare e cila merr rrugën e angazhimit dhe të banalizimit të poetikës për hesap të politikës. Siç tashmë dihet, poezia ashtu si tërë letërsia shqipe, bëhet instrument i propagandës totalitare dhe si e tillë ajo detyrohet të modelohet për qëllimet e kësaj propagande.

“Qysh se ekzistojnë lëvizjet totalitare në një botë që në vetvete nuk është e tillë, - thotë Anah Arendt në librin e saj origjinal e totalitarizmit, ato detyrohen t’i drejtohen asaj çka zakonisht e njohim si propagandë. Por një propagandë e tillë, gjithnjë i drejtohet një sferë të jashtme qoftë kjo shtresa jototalitare e popullsisë në vend apo në vendet jototalitare jashtë”<sup>2</sup>.

Letërsia dhe arti janë mjeti më efikas i komunikimit me këto shtresa dhe regjimi komunist i kontrollon dhe i përdor në kuadrin e makinës së saj propagandistike. Rezultatet dihen: letërsisë i caktohet një program dhe vepra letrare duhet të jetë sendërtim i këtij programi. Ajo skematizohet, banalizohet në nivelin e tekstit e të ideve deri në atë shkallë sa shndërrohet në një lloj publicistike propagandistike. Disa shkrimtarë i shmangen modelit e kjo është arsyeja pse kemi vepra të tilla si ajo e Kadaresë apo e ndonjë tjetri, por përgjithësisht kemi krijimin e një letërsie ekstremisht të angazhuar në përhapjen e doktrinës dhe të propagandës së regjimit.

Përkundër këtij modeli Camaj e ka poezinë qëllim, jo mjet. Për këtë arsye ndoshta Camaj bën pjesë ndër të paktët autorë që i përkushtohet poezisë së pastër. Ai ndjek kështu modelin e Mjedës dhe Poradecit. Ai e shkruan poezinë për të fiksuar mendimin dhe ndjenjën, botën dhe sendet e saj. Procesi i poetizimit është njëherësh proces i interiorizimit të botës dhe procesi mental dhe shpirtëror që e shoqëron atë i ngjan pak a shumë metamorfozës së murgut, i cili i shmanget botës për ta interiorizuar atë. Poezia është lutja e Camajt. Ai, siç thoshte Malarmé, i rikthen fjalës “statusin e saj bazë, monumental, e izolon për ta kundruar së jashtmi”. Në njëfarë mënyre ai i kthen si askush tjetër më parë artit të fjalës funksionin poetik si funksionin bazë, por pa e çuar në ekstremitet një gjë të tillë, pasi ai është i vetëdijshëm më tepër se kushdo tjetër se funksioni poetik mund të jetë mbizotërues por jo edhe ekskluziv.. Vargu i Camajt të kujton më

<sup>2</sup> Anah Arendt, *Origjinal e totalitarizmit*, f. 442, Dija, Prishtinë, 2002.

shumë se kushdo tjetër moton krijuese të poetit francez Pol Valery, i cili e konsideronte vargun “një ekuilibër i mrekullueshëm dhe i paqëndrueshëm mes elementeve ndjesore dhe intelektuale të gjuhës”.

Është thënë shumë, madje deri në abuzim se Camaj është poet hermetik. Hermetizmi i tij lidhet gabimisht edhe me hermetizmin e Ungaretit, gjë që mua më duket e pabazë. Kam përshtypjen se në themel të këtij keqkuptimi qëndron një fakt i thjeshtë biografik që lidhet me faktin se Camaj ka ndjekur disa kurse të Ungaretit për poezinë në Universitetin *La Sapienza*. Nëse duhet ta bëjmë me patjetër Camajn dishepull të ndonjë poeti, me siguri që ai është më i ngjashëm me Montalen se sa me Ungaretin. Ai ngjan veçanërisht me Montalen e vëllimit *Ossi di Sepia*. Mendoj se poezia e tij nuk është hermetike. Ajo e ka si tipar errësinë, por jo hermetizmin. Poezia e tij si gjithë poezia moderne e shekullit të kaluar ka ambicien kontradiktore të përfaqësojë si shprehjen e kuptimit, ashtu edhe fshehjen e tij. Nëpërmjet errësisë gjuha poetike diferencohet nga gjuha e përditshme e cila është e destinuar për kumtime të drejtpërdrejta. Errësimi i gjuhës tek poetët modernë duhet parë edhe si një revoltë estetike ndaj banalizimit të saj nga sistemet e komunikimit masiv dhe sidomos nga përdorimi propagandistik i gjuhës nga regjimet totalitare ku gjuha përdoret në shërbim që qëllimit:thjeshtëzo dhe përsërit. Camaj jo vetëm që i shpëton gjuhës totalitare të regjimit por i shfaqet asaj si një formë alternative komunikimi.

“Të shkruash poezi thoshte – Malarmé, do të thotë të penetrosësh në shtresat më të thella të gjuhës, të bësh kombinime të tilla që i ngjajnë formulave matematike”, - dhe Camaj e mishëron më së miri këtë parim. “Fjala, thotë Camaj, ka një jetë shekullore, ajo reflekton në kaq e kaq histori lloj-lloj gjërash, ajo na vë në dialog me shumë njerëz që mund të jenë zhdukur nga faqja e dheut, por që kanë kënë këtu shpirtin e tyre”<sup>3</sup>

Marrëdhënia e tij me gjuhën shpreh të veçantën e marrëdhënies së tij me botën shqiptare. Camaj është shkrimtari *par excellence* i ekzilit që i ik vazhdimisht botës së vet. Pasi arratiset nga Shqipëria, ai mbërrin në Kosovë, qëndron në Beograd një kohë të shkurtër, e më së fundi mbërrin në Itali, në Romë. Italia e mban ende në kontakt me botën shqiptare pasi Koliqi dhe katedra e shqipes së Romës ishin shumë të lidhura me botën arbëreshe. Por Camaj largohet edhe nga Roma duke zgjedhur botën gjermanike. Me gjithë këtë ikje të vazhdueshme, është e vështirë të gjesh ndër poetët shqiptarë një tjetër poet ku bota shqiptare të jetë kondensuar

---

<sup>3</sup> Klosi, Ardian, *Takim me Martin Camajn*, f. 27. Martin Camaj, *Vepra Letrare*, Apollonia, Tiranë, 1997

dhe konservuar aq fort. Madje një gjë të tillë e pohon edhe vetë Camaj i cili thotë se “Kujtesa është temë esenciale e poezisë sime. Njeriun e bën njeri kujtesa: gjithçka çdo impuls, çdo vuajtje buron nga aftësia për të kujtuar... kujtesa të sjell tek poezia, sepse është kujtesa ajo që bart njeriun”<sup>4</sup>. Duket se Camaj i beson së tepërmi aftësisë së poezisë për ta metamorfizuar, shkatërruar dhe rindërtuar botën. Raporti i poezisë moderne me botën është i shumëfishtë por rezultati është gjithnjë i njëjti: transfigurimi i botës reale në një botë imagjinare. Kadenca e vargjeve të Camajt është kadenca e rrjedhjes së ngjarjeve, personazheve, pamjeve në kujtesën e një njeriu që mendon gjatë dhe ngeshëm. Në kundërshtim me poetikën bashkëkohore, alterpoetika e tij nuk është veprim, por ëndërrim, imagjinatë. Ajo është një gjendje shpirtërore dhe poetike impersonale e vështirë për t’u shijuar nga njeriu i ri shqiptar, nga ky produkt parafabrikat i propagandës tjetërsuese komuniste. Dhe deri sa kjo propagandë ta ketë nën kontrollin e metastazave të veta njeriun shqiptar, poezia e Camajt do ta ketë të vështirë të pranohet, shijohet dhe ta bëjë jetën e vet normale.

---

<sup>4</sup> Po aty. f. 27.